



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality



Duke u bazuar në nenin 12, neni 17 dhe 40 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27/2008), Rregullores mbi lartësinë e taksave, ngarkesave dhe gjobave Komunale 01 Nr.06-15345/1 të dt. 28.08.2014, Rregullores mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores mbi lartësinë e taksave, ngarkesave dhe gjobave Komunale 01 Nr.06-8491/1 dt.31.05.2016 neni 32.2 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, pas shqyrtimit dhe votimit paraprak Kuvendi i Komunës merr:

V E N D I M

Për faljen e borxhit të pa paguar për taksën në biznes

Neni 1

Me këtë vendim bëhet falja e borxhit të pa paguar për taksën në biznes, për të gjithë taksapaguesit e Komunës së Dragashit nga data 01.01.2000 deri më 31.12.2012 për arsye se janë borxhe të vjetra dhe nga viti 2012 komuna nuk i ngarkon bizneset me taksë biznesi.

Neni 2

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, do të shlyhen nga evidenca e borxheve të pa paguara për taksën në aktivitet, të gjitha borxhet e taksapaguesve, për periudhën e cekur si në nenin I të këtij vendimi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria e Ekonomisë, Financa dhe Zhvillim.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të prodhojë efekt juridik, pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81 dhe 82 të LVL-së.

I dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Dragash-it z.Bexhet Xheladini
- Drejtorisë së Ekonomisë, Financa dhe Zhvillim
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (Zyrës Ligjore) – Prishtinë dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH
01 Nr. 060/01-30136/22-4
Dt. 15.11.2022



Kryesuesi i Kuvendit:
Uran Hafimi